

djali i Sadikut, Ramizi, si dhe Qerimi me djemtë Ukshinin, Shahinin dhe kushërin Valdetin, iu bashkëngjiten mbrojtjes së fshatit. Shtënin ndaj policisë nga shtëpitë e veta. Shtëpia e Hamitit ka qenë objekt sulmi tërë ditën. Pasdite, nga ciflat e granatës u plagos Smajli. Pas pak, ai dha shpirt nga plagët vdekjeprurëse. Gjatë ditës, kulmi dhe muret e shtëpisë filluan të qaheshin dhe të rrënoheshin nga goditjet e predhave dhe plumbave. Kjo i detyroi që të kalonin në shtëpinë e Sadikut. Gjatë kalimit, e qëlluan për vdekje Salen.

Sadiku ndodhej në shtëpi me bashkëshorten Afijen, djalin Hamdiun dhe vajzat Fatimen dhe Elfijen, e cila kishte ardhur në vizitë te prindërit dy ditë para sulmit mbi fshatin. Pas pak, edhe shtëpia e Sadikut nisi të rrënohej nën goditjet e predhave dhe plumbave. Elfija, e cila ka qenë shtatzëne, u plagos në gjoks nga një granatë. Të shtënat pushuan pakëz gjatë natës, por sërish u intensifikuan në mëngjesin e datës **6.03.1998**. Sadiku, Afija, Fatimja, Elfija dhe Fatime Bazaj kanë zbritur në bodrumin e shtëpisë, ndërkaq Hamiti, Shahini dhe Valdeti kanë mbetur në një dhomë, në katin e parë të shtëpisë. Njëherësh, Ukshini dhe Ramizi shkuan në katin e dytë të shtëpisë, nga ku e vazhduan rezistencën. Në mbrëmje, një predhë ka depërtuar në dhomën ku gjendeshin Hamiti, Shahini dhe Valdeti. Hamitin e ka vrarë në vend, ndërsa Shahini dhe Valdeti u plagosën. Ashtu i plagosur, Shahini ka dal jashtë shtëpisë dhe kjo ishte hera e fundit kur ata e kanë parë të gjallë. As Sadikun, Afijen, Fatimen Jashari, Elfijen dhe Fatimen Bazaj, askush nuk i kishte parë kurrë më.

Në mëngjes, më 7.03.1998, policët serb i kanë marrë trupat e pajetë të Hamitit, Sales, Shahinit, Ukshinit, Qerimit, Hajrijes dhe Ramizit. U varrosën më 11.03.1998 në varrezat e *Mëhallës Jashari*.

Trupat e Afije, Fatime, Elfije dhe Hamdi Jasharit, si dhe të Fatime Bazajt nuk janë gjetur ende. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Afijes është sistemuar në lëndën me numër BLG-805039-02, i Fatimes me BLG-805039-05, i Elfijes me BLG-805039-04, ndërkaq ai i Hamdiut me BLG-805038-01. Mbetjet mortore të Sadi-

kut u gjetën disa vjet pas lufte. U identifikuan në vitin 2006 dhe u varrosën në varrezat e *Mëhallës Jashari*. Mbetjet mortore të Smajlit u identifikuan më 3.03.2011 dhe u varrosën më 6.03.2011 në varrezat e *Mëhallës Jashari*.

Burimet: deklarata V.J, FDH-20309; deklarata N.N, FDH-32465; deklarata Z.B, FDH-20284; KMDLNI, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 17-18, 130-131, FDH-23807; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oruzanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; J. Martinsen, *Registri..*, FDH-26092; SHFUDUÇK, *Feniksët...3*, strane 215-217, 221-224; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795; *Rivarrim në Prekaz*, Zëri, 4.03.2011, 18, FDH-37668; *Identifikohen mbetjet mortore të dëshmorit Smajl Bazaj*, Koha Ditore, 4.03.2011, 15, FDH-37669; FHP, penale (Radoslav Mitrović dhe të tjerë), 2.03.2009, FDH-36787.

Hamide (Jashar Kelmendi) Jashari

(4.02.1913, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, shtatë fëmijë)

Kajtaç (Maliq) Jashari

(14.10.1953, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, ish punëtor i Fabrikës së Municionit, katër fëmijë)

Ajvaz (Kajtaç) Jashari

(2.07.1980, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës gjimnazi)

Hamiden e moshëthyer, të birin Kajtaçin me djalin Ajvazin për herë të fundit i kanë parë të gjallë në mëngjesin e datës **5.03.1998**, kur filloi sulmi i policisë serbe ndaj **Prekazit të Poshtëm/Donje Prekaze**. Djali tjetër i Hamidës, Ragipi, i cili ka qenë pjesëtar i UÇK-së, në atë kohë gjendej në shtëpinë e Shaban Jasharit. Nuk diti asgjë për fatin e familjarëve përderisa policia serbe nuk i ka ekspozuar trupat e tyre të pajetë në oborrin e depos së materialit ndërtimor të *Lah Tushiles*. Atëherë, ai i identifikoi trupat e tyre. Në trupin e Hamides vëreheshin shtatë plagë nga plumbat, ndërkaq Kajtaçi dhe Ajvazi i kishin nga pesë plagë. U varrosën me viktima të tjera në varrezat e *Mëhallës Jashari*.